



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.4.2023

Nr: 356

Ora: 14:51

VENDIM
PËR

NDALIMIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË BASHKISË BELSH

Sot më datë 14.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBEKT: Bashkia Belsh

OBJEKTI: Ndalim i zhvillimit të veprimtarive me karakter publik, të raportuar nga Bashkia Belsh

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, neni 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në datën 12.4.2023, Bashkia Belsh ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 4 (katër) veprimtari publike me objekt:

1. Aktivitetin me temë “*Takim në familje të ndryshme*”, raportuar më datë 12.4.23 për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 11:30-12:30 me vend zhvillimi: Vizitë në familje, me pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë Belsh dhe Nënkyetari
2. Aktivitetin me temë: “*Takim me banorët e fshatit Qafë Shkallë*”, raportuar më datë 12.4.23 për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 10:00-11:00 me vend zhvillimi: në mjedis të pacaktuar, me pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë Belsh dhe Nënkyetari

Data:14.4.2023 Nr: 356
Ora: 14:51



“Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik të Bashkisë Belsh”.

3. Aktivitetin me temë: *“Takim prezantues”*, raportuar më datë 12.4.23 për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 12:00 me vend zhvillimi: në mjedis të pacaktuar, me pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë Belsh dhe Nënkryetari
4. Aktivitetin me temë: *“Takim me banorët e fshatit Shkendi”*, raportuar më datë 12.4.23 për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 10:00-11:00 me vend zhvillimi: në mjedis të pacaktuar, me pjesëmarrës: Kryetari i Bashkisë Belsh dhe Nënkryetari

Referuar nenit 92, pikat 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, parashikohet se institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Përbëjnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë e hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin e publikut, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Raportimi në ndërfaqe duhet të kryhet jo më vonë se pesë ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose aktivitetit publik.

Qëllimi i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike qendrore e vendore, agjencive, enteve dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, është marrja e masave, monitorimi dhe parandalimi i veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore si dhe të administratës shtetërore.

Mosraportimi në kohë i veprimtarisë kufizon mundësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vlerësuar nëse përbën veprimtari të ndaluar ose jo.

Gjithashtu, në raportimin e kryer në ndërfaqe, konstatojmë se mungojnë elementët e plotë të raportimit, vendi i zhvillimit nuk është i specifikuar qartë, tematika e aktivitetit të raportuar, kush i organizon këto aktivitete dhe identifikimin e pjesëmarrësve.

Për sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të dhënat e paraqitura në raportim ka konstatuar se, aktivitetet e raportuara nga institucioni publik, Bashkia Belsh janë raportuar jashtë afatit ligjor, në kuptim të nenit 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të

Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

V E N D O S:

1. Ndalimin e zhvillimit të veprimtarive publike me temë:
 - a) “Takim në familje të ndryshme”, për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 11:30-12:30, me vend zhvillimi: Vizitë në familje,
 - b) “Takim me banorët e fshatit Qafë Shkallë”, për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 10:00-11:00, me vend zhvillimi: në mjedis të pacaktuar,
 - c) “Takim prezantues”, për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 12:00, me vend zhvillimi: në mjedis të pacaktuar,
 - d) “Takim me banorët e fshatit Shkendi”, për t’u zhvilluar më datë 16.4.2023 ora 10:00-11:00, me vend zhvillimi: në mjedis të pacaktuar.
2. Vendosjen e shënimit “*Ndaluar nga KQZ*” në ndërfaqen e raportimit.
3. Njoftimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive të mos lejojë transmetimin apo pasqyrimin në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione.
4. Ky vendim i njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI